

KARTË GARANCIE

Modeli+Indeksi:	Nr.serie: <input type="text"/> <input type="text"/> . <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> . <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> . <input type="text"/>
Data dhe vendi i blerjes: Vula:	Blerësi: Jam në dijeni për kushtet e garancisë. Nënshkrimi:

Liebherr ju falënderon për zgjedhjen tuaj dhe ju uron për blerjen e kësaj pajisjeje me cilësi shumë të lartë duke shpresuar ta gëzoni për një kohë të gjatë, me kënaqësi dhe pa problem.

Ne, Liebherr-Hausgerete Marica EOOD, e quajtur në këtë garanci „Liebherr”, me adresë : 4202 Radinovo, bashkia Marica, qarku Plovdiv, në cilësinë e prodhuesit të pajisjes që keni blerë, ju ofrojmë 36 muaj garanci të plotë tregtare për rregullsinë teknike të pajisjes që keni blerë në territorin e Republikës së Shqipërisë duke respektuar kushtet e garancisë që janë përshkruar në këtë kartë garancie.

Afati i garancisë fillon nga data e blerjes së pajisjes nga blerësi dhe deri në skadimin e tij të gjitha parregullsitë teknike që mund të vijnë si pasojë e një difekti fabrike ose një shkak tjetër të prodhuesit, do të eliminohen pa pagesë (riparim), dhe kur difekti nuk mund të eliminohet, pajisja do të zëvendësohet me një tjetër të re të po këtij modeli pa pagesë shtesë nga ana juaj.

Garancia është e vlefshme vetëm me paraqitjen e kuponit fiskal/faturës të lëshuar gjatë blerjes dhe të kartës origjinale të garancisë. Karta e garancisë që ka numër serie të palexueshëm, ose që është plotësuar në mënyrë jo korrekte, ose që ka shenja intervenimi, është e pavlefshme.

Garancia nuk zbatohet:

- për pajisje që përdoren për veprimtari tregtare dhe/ose profesionale, si dhe për çfarëdo qëllimi tjetër, përveç për përdorim shtëpiak.
- për pjesët e konsumueshme të pajisjes – të gjitha pjesët e lëvizshme nga korpusi kryesor i produktit, përfshirë, por jo vetëm, vaska, pjesë shtesë, kablo, llambushka, zorra, furçe, filtra; të gjitha nyjet prej qelqi, gome dhe të tjera që konsumohen dhe amortizohen me kalimin e kohës;
- për difekte kozmetike në pamjen e jashtme të pajisjes, si gërvishtje, plasaritje, ndryshim ngjyre ose ndryshk;
- për dëmtime të shkaktuara si rezultat i problemeve në rrjetin elektrik (tension i ulët/i lartë), goditje elektrike, zjarr, përmbytje, tërmet, veprime luftarake, si dhe çdo rast të forcës madhore

Reklamimet mund të refuzohen në rastet kur:

- > nuk janë respektuar kushtet e treguara në manual (p.sh. instalim jo i drejtë) LEXOJENI DETYRIMISHT INSTRUKSIONIN E PËRDORIMIT TË PAJISJES!
- > dëmtimet janë pasojë e përdorimit të pakujdesshëm; gjatë transportimit; të shkaktuara nga insekte, kafshë ose shkaqe të tjera që nuk varen nga Liebherr;
- > dëmtimi është shkaktuar me paramendim;
- > pajisja është përdorur në kushte të papërshtatshme;
- > është bërë provë për ndreqjen e difektit nga persona të paautorizuar;
- > për pastrimin e pajisjes janë përdorur preparate që nuk janë miratuar nga Liebherr;
- > nuk janë përdorur aksesore dhe/ose pjesë origjinale;
- > ka korrigjime ose ndryshime në kartën e garancisë ose në faturë dhe ka mospërputhje midis dokumenteve dhe vetë mallit, ose kur tabela e modelit dhe numrit të serisë është hequr ose është dëmtuar.

Si mund të paraqisni një reklamim:

Personi të cilit i paraqitet garancia tregtare (reklamimi) është tregtari, prej të cilit është blerë pajisja, ose servisi i autorizuar.

Kur paraqisni reklamimin, ju duhet të tregoni detyrimisht numrin e serisë të pajisjes dhe gjithashtu të paraqisni këtë kartë garancie, si dhe dokumentin e pagimit të çmimit të blerjes: faturën ose kuponin fiskal.

Në rast reklamimi, kur pasi të jetë bërë diagnostikimi i nevojshëm, konstatohet se pajisja - objekt i reklamimit, i përgjigjet specifikimit teknik të vlefshëm për të, pra pajisja nuk ka pësuar difekt ose që shkak i difektit është mosrespektim i kushteve të garancisë, blerësi (klienti) duhet t'i paguajë servisin diagnostikimin e bërë sipas listës së çmimeve të servisit.

Serviset e autorizuara për riparime garancie në territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

Expert Servis
Customer Service
Tel : +35544806061
Mob: +355696045555
info@expert-servis.al

Elektro Servis
Tel : +35542278131
Fax: +35542278130
E-Mail: info@elektro-servis.com

Ngjitni këtu stikerin me të dhënat e pajisjes. Tek modelet e reja stikeri i bashkëngjitet manualit të përdorimit të pajisjes. Nëse nuk ka një stiker bashkëngjitur, kopjoni nga tabela e pajisjes të dhënat e nevojshme.

Service-Nr.

<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	-	<input type="text"/>	<input type="text"/>
----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	---	----------------------	----------------------

Data dhe përshkrimi i riparimit:
Data dhe përshkrimi i riparimit: